


SEO këshilla për bllogerë për përfaqësim Doracak nga The Sudanese Thinker

**Si të nxisni optimizimin te kërkuesit që të zmadhoni numrin e lexuesve dhe të ndikoni mbi sa më shumë njerëz.**





Një numër i madh bllogerësh për përfaqësim nga mbarë bota, çdo ditë me gjithë zemër vendosin bllogje, sepse duan të dëgjohen dhe dëshirojnë të bëjnë ndryshime pozitive.



Megjithatë, realiteti është se për shumë prej nesh, kjo gjë mund të ketë përvojë me frustrime.

Megjithatë, shumica e bllogerëve individualë kanë një numër të vogël vizitash. Ju shkruani dhe botoni, por shumë pak njerëz lexojnë se çfarë keni ju për të thënë.

Shumë pak njerëz bëjnë komente.

Lajmi i mirë është se situata nuk duhet të jetë kaq deprimuese për bllogerët të cilët kalojnë nëpër këtë proces.

Për këtë situatë do t'ju ndihmojë ky doracak. Qëllimi i tij është të shpjegojë çfarë është optimizimi për kërkues, rëndësia e tij dhe si mund ta shfrytëzojnë bllogerët për përfaqësim që ta:

1. Zmadhojnë numrin vizitorëve dhe lexuesve
2. Të ndikojnë mbi mendimet e atyre të cilët i shfrytëzojnë kërkuesit

Domethënë, nëse jeni blloger për përfaqësim apo dëshironi të jeni, përgatituni, sepse me këtë udhëzues do të mësoni disa triqe të vogla për optimizim për kërkues.

COOL?

Atëherë në rregull, eja t'ia fillojmë. :)



## Domethënë, çfarë është SEO?



SEO-si është shkurtesë e optimizimit të kërkuesve (search engine optimization), e cila përmban këshilla dhe praktikat më të mira nëpërmjet të cilave mund ta rrisni rangun e bllogut tuaj te kërkuesit siç janë Google dhe Yahoo.



Qëllimi është i thjeshtë: blloku juaj të shfaqet lart në listën e faqes së parë të kërkuesve gjatë kërkimit të fjalëve kryesore relevante.

Për shembull, nëse keni bllok ku shkruhet me censurë on-line, atëherë është ideale, ju dëshironi blloku të radhitet lart tek kërkuesit për fjalët kryesore lidhur me atë temë.

Beneficionet janë të dukshme. Së pari, do të rritet numri i lexuesve të bllokut tuaj falë njerëzve që do të klikojnë në linkut e bllokut tuaj që do të dalë në rezultatet që do të japin kërkuesit.

Gjithashtu, sa kohë që rangi juaj do të jetë i lartë, do të vazhdoni të keni vizitorë target me muaj edhe pse jo edhe me vite. Së dyti, sa më shumë vizita të ketë, përfaqësimi juaj do të krijojë ndikim më të madh.

Kalimi në optimizim të thjeshtë për kërkim është e lehtë, por ju nevojitet të keni durim dhe të jeni konsekuentë para se të filloni të merrni rezultate të rëndësishme.

Ndërsa tani, le të fillojmë ta diskutojmë hapin e parë.



## Hapi #1 – Përzgjidhni temat e bllogut tuaj për SEO



Kur bëhet fjalë për optimizim të kërkuesve, është shumë e rëndësishme të përcaktoni qëllime reale. Thjeshtë nuk mund të prisni që blloku juaj të rangohet lart për mijëra fjalë kryesore.

Duhet të veproni në mënyrë strategjike, kurse hapi i parë që ta arrini është të vendosni se cilat janë temat specifike për të cilat dëshironi të arrini një rangim të lartë.

Së dyti, duhet të jeni të vetëdijshëm për konkurrencën, e cila tashmë dominim te kërkuesit me fjalë kryesore të cilat ju dëshironi t'i shfrytëzoni. Me fjalët kryesore që janë të famshme si “Afrika”, “tenis” apo “Uoll Strit” është shumë e vështirë të arrini rangim të lartë. Eueb-sajtet e mëdha dhe të rëndësishme, të cilat kanë reputacion të mirë, si Uikipedia, zakonisht i kanë zënë pozicionet e larta për fjalët kryesore më të njohura.

Së treti, ju duhet t'i drejtoni përpjekjet tuaja kah temave të vogla dhe specifike. Për shembull, nëse planifikoni të shkruani për Afrikën, mos e përzgjidhni “Afrika” si fjalë kryesore në titullin e bllog-postit tuaj. Kjo është temë mjaft e gjerë. Në vend të kësaj fjale, mund të përzgjidhni temë specifike si “Zgjedhje në Kenia”.

Së katërti, ju është e dukshme se dëshironi të siguroheni se keni publik përkatës i cili do ta kërkojë informacionin të cilin ju e ofroni. Nëse e keni optimizuar postin me fjalët kryesore “humbje peshe e majmunëve rozë”, sigurisht mund të jeni në vendin e parë gjatë kërkimit në Google.

Por, mos festoni menjëherë, sepse ekzistojnë diku 12 njerëz të cilët e kërkojnë këtë temë njëherë në vit. Ndoshta jo saktësisht 12, por e dini se çfarë mendoj. Ky është një publik shumë i vogël, pothuajse jo ekzistues.

Për bllogerët specialistë, të cilët janë të fokusuar te një temë kryesore si për shembull të drejtat e emigrantëve, gjetja e fjalëve kryesore është proces shumë i thjeshtë.

Nëse mbulonit tema të përgjithshme, nuk mund të prisni rangim të lartë për të gjitha tema. Duhet të fokusoheni te një apo dy tema, për të cilat më shpesh keni bllogje.

Mbani mend, përzgjidhni temë konkrete. Domethënë është e qartë?


Super, hapi tjetër.

## ☆ Hapi #2 – Kërkimi dhe seleksionimi fjalëve kryesore

Deri tani, ndoshta keni bërë pyetjen “në rregull, i përzgjedha temat e mia, por si t’i përzgjedh fjalët e duhura kryesore, të cilat do t’i përdor për bllogun tim?”

Pyetje me vend.

Përshëndeteni mjetin Google për kërkim të fjalëve kryesore. Është falas, i shpejtë dhe i lehtë për përdorim. Që ta gjeni, hapni Google dhe kërkoni „[Google keyword tool](#).”



The screenshot shows the Google Keyword Tool interface. On the left, under the heading "How would you like to generate keyword ideas?", there are two radio button options: "Descriptive words or phrases (e.g. green tea)" which is selected, and "Website content". On the right, there is a text input field with the placeholder "Enter one keyword or phrase per line:" containing the text "kenya elections". Below the input field, there is a checkbox labeled "Use synonyms" which is currently unchecked.

Mjeti ju mundëson të shihni përqindjen e qarkullimit (vizitave) për një muaj kërkim në lidhje me një fjalë apo frazë kryesore të caktuar të Google.

Mjeti gjithashtu jep një listë të fjalëve kryesore të ndërlidhura dhe tregon se çfarë qarkullimi (sa vizitorë) kanë mundësuar ato nëpërmjet Google.

Këto të dhëna do t’ju ndihmojnë që të keni një ide më të mirë për atë se çfarë kërkon publiku juaj kur viziton Google dhe gjatë kësaj ka lidhje me temat tuaja.

Global Monthly Search Volume	
Keywords	Volume
Keywords related to term(s) entered - <a href="#">sort by relevance</a>	
kenya election	8,100
kenya elections	2,900
post election violence kenya	2,900
elections in kenya	720
kenya elections 2007	590
kenya elections violence	170
kenya elections 2008	91

Nga fotografia më sipër, mund të vërehet se fraza “zgjedhje në Kenia”, sipas vlerësimit të Google është përkuar 2.900 herë në muaj.

Ky është një numër mjaft i mirë, kurse kur unë bëra kërkim në Google, gjejini se çfarë u shfaq në faqen e parë. Po, bllok post nga Global Voices Online. Nuk është keq.


[Global Voices Online » Kenya Elections Aftermath 2008](#)  
**Kenyan election** day On Dec. 27, 2007 a surprise victory for former pres (PNU) in the **Kenyan** presidential **election** was followed by arson and ...  
[globalvoicesonline.org/.../kenya-elections-aftermath-2008/](#) - [Cached](#) - [S](#)

Searches related to **kenya elections**

[kenya elections 2008](#)      [kenya elections obama](#)      [africa elections](#)  
[kenya news](#)                      [daily nation](#)                      [raila odinga](#)

First page ranking    
1 2

Tani, ejani t'i shohim akoma shembuj. Kur kërkova në Google "censurë në Tunizi" mu shfaqën këto rezultate në faqen e parë:



The screenshot shows a Google search interface with the query "censorship tunisia" in the search bar. The search button is labeled "Search" and there is a link for "Advanced Search". Below the search bar, the results are categorized under "Web" with a "Show options..." link. The results list includes:

- Censorship in Tunisia - Wikipedia, the free encyclopedia** ☆  
Censorship in Tunisia has been an issue since the country gained independence in 1956. Though considered relatively mild under President Habib Bourguiba ...  
[Pre-Bourguiba - Bourguiba era - Ben Ali era: Legal provisions](#)  
[en.wikipedia.org/wiki/Censorship\\_in\\_Tunisia](#) - [Cached](#) - [Similar](#)
- Internet in Tunisia - Wikipedia, the free encyclopedia** ☆  
Jump to **Censorship**: **Censorship**. See also: **Censorship in Tunisia**. Internet censorship in Tunisia is very strong. Technically, it is a transparent proxy ...  
[en.wikipedia.org/wiki/Internet\\_in\\_Tunisia](#) - [Cached](#)
- [Show more results from en.wikipedia.org](#)
- Tunisia chided over Web censorship - The New York Times** ☆  
15 Nov 2005 ... In its report, called "False Freedom: Online Censorship in the Middle East and North Africa," Human Rights Watch also cited censorship and ...  
[www.nytimes.com/2005/11/15/business/.../15iht-censor.html](#) - [Cached](#)
- A blogger in Tunisia: My life with the censor - Blog - Committee ...** ☆  
30 Apr 2009 ... The specter of government opposition to blogging, journalism, and free expression in general in Tunisia is so intense that the mere ...  
[cpj.org/.../a-blogger-in-tunisia-my-life-with-the-censor.php](#) - [Cached](#) - [Similar](#)
- Tunisia's Dubious Honor In Internet Censorship : Nawaat** ☆  
4 Apr 2009 ... The Freedom on the Net Index has ranked Tunisia second only to Cuba and on par with China in censoring the Internet. ...  
[www.nawaat.org/.../tunisias-dubious-honor-in-internet-censorship/](#) - [Cached](#) - [Similar](#)

Dy linket e para janë nga Vikipedia, linku i tretë është nga Nju-Jork Tajmsi, i katërti nga sajti i Komitetit të Mbrojtjes së Gazetarëve dhe i fundit është i Nawaat, ueb-sajt i menaxhuar nga aktivistë tunizezë të cilët luftojnë për lirinë në Tunizi.

Tani, parafytyroni e gjithë faqja e parë të ishte e mbushur me linke të promovuar nga Qeveria e Tunizisë ku e shpjegon pozicionin e vet..

Sa më ndryshe do të ishte kjo në krahasim me situatën ku e gjithë faqja e parë është e mbushur me linke të bllogerëve nga Tunizia për përfaqësim, të cilët e shpjegojnë aspektin e vet të Punëve?



Ajo që ofron optimizmi për kërkuesit e bllogerëve për përfaqësim është kjo: kur ata dominojnë në faqen e parë të Google për një frazë të politizuar, e cila kërkohet shumë shpesh, ata mund të ndikojnë theksueshëm mbi mendimin e atyre që e kërkojnë atë.

Ja edhe një shembull tjetër relevant. Kjo më doli kur kërkoja në Google frazën „torture egypt (Torturë Egjipt).“



The screenshot shows a Google search interface with the query "torture egypt" entered in the search box. The search results are displayed under the heading "Web" and "Results 1 - 10". The first result is titled "Torture in Egypt | التعذيب في مصر" with a star icon. The snippet below the title reads: "La torture fait de celui qui le subit quelqu'un qui déteste son propre pays ! Say like Obama (Yes we can) and we can stop torture in Egypt. ...". The URL is "www.tortureinegypt.net/english" and it is marked as "Cached" and "Similar". Below this, there is a link to "Translate this page" and a snippet in Arabic: "ينشر حالات انتهاك حقوق الإنسان التي تمارسها الجهات الشرطية و الأمنية في مصر، و يوثق شهادات الضحايا و ملفات المؤسسات الحقوقية." The URL is "tortureinegypt.net/" and it is marked as "Cached". The second result is titled "YouTube exposes torture in Egypt | News | guardian.co.uk" with a star icon. The snippet reads: "12 Jan 2007 ... American politicians quickly realised that no moment was private in the age of YouTube, and now Egyptian authorities are learning the same ...". The URL is "www.guardian.co.uk/news/blog/2007/jan/.../youtubeexposes1" and it is marked as "Cached" and "Similar". The third result is titled "Egypt Human Rights Violations: History of Torture in Egypt" with a star icon. The snippet reads: "Egypt has been torturing terrorism suspects since its battle with domestic terrorists in the 1990s. Now it is torturing suspects from the US and UK on ...". The URL is "terrorism.about.com/od/humanrights/a/EgyptTorture.htm" and it is marked as "Cached" and "Similar". The fourth result is titled "Egypt's Torture Video Sparks Outrage - TIME" with a star icon. The snippet reads: "23 Jan 2007 ... Once it was only Islamist militants who could expect torture in police stations; now even apolitical citizens run the risk of being ...". The URL is "www.time.com/time/world/article/0,8599,1581608,00.html" and it is marked as "Similar".

Rezultati i parë është i një ueb-sajti i cili menaxhohet nga një aktivist i blloger egjiptian për përfaqësim. Sajti është i specializuar për zbulimin e rasteve të torturës në Egjipt dhe ka arritur rezultate të përkryera në përfshirjen e padrejtësive.

Ekzistojnë shumë shembuj të tjerë për bllogerë për përfaqësim, të cilët e promovojnë kauzën e vet dhe janë ranguar shumë mirë prej kërkuesve.

Megjithatë, siç thashë, para se të fillohet me implementim, puna e parë është hulumtimi dhe seleksionimi i fjalëve kryesore.



Megjithatë, para se t'i përzgjidhni fjalët tuaja kryesore, ndonjëherë është e dobishme t'i shikoni rezultatet e faqes së parë në Google që të kontrolloni konkurrencën.

Në qoftë se linket e Vikipedisë dhe sajtet gazetareske on-line, si BBC dhe “Nju-Jork Tajms” i okupojnë rezultatet e para, kjo është indikator se nuk mund të prisni në rangim të mirë shumë lehtë.

Nëse nuk ka shumë linke të ueb-sajteve të mëdha dhe të njohura, shanse që të gjendeni në faqen e parë janë shumë më të mira.



### Hapi #3 – Përdorimi i fjalëve kryesore në bllogun tuaj



Tani pasi bëtë listë me disa fjalë kryesore, të cilat përdoren gjatë përdorimit, hapi tjetër është t'i shfrytëzoni në bllogun tuaj.

Në përgjithësi, ato duhet t'i përfshini në:

1. Titujt e artikujve tuaj
2. Nëntitujt e artikujve tuaj
3. Në paragrafin e parë të artikullit tuaj

Megjithatë, nëse keni një bllok të specializuar, atëherë mund t'i vendosni fjalët kryesore edhe në:


1. Titullin e bllokut tuaj
2. Misionin e bllogut
3. Njërin prej kategorive të bllogut

Në qoftë se e kryeni këtë që është dhënë më sipër do ta përmirësoni rangimin e bllokut tuaj.

Kjo ndodh kështu sepse kur Google e skenon rrjetën duke kërkuar përmbajtje për indeksim, e kontrollon përmbajtjen e faqeve.

Njëra prej gjërave të shumta që i shikon është titulli i faqes apo bllokut. Prandaj, përpiquni t'i optimizoni këta tituj që të kenë një performancë më të mirë te kërkuesit.

Që ta bëni këtë për WordPress blog, shkoni në Settings > General.

 **General Settings**

Blog Title	<input type="text" value="The Sudanese Thinker"/>
Tagline	<input type="text"/>
WordPress address (URL)	<input type="text" value="http://www.sudanese thinker.com"/>

Atëherë mund të vendosni mision (tagline) i cili i përmban fjalët kryesore të përzgjedhura.

Nga ana tjetër, këtu shohim se si Global Voices Online e bën këtë për një artikull. Ndoshta nuk është bërë me qëllim për optimizim të kërkuesit, por megjithatë është praktikë e mirë.

 **GlobalVoices**  
The world is talking. Are you listening?

**Countries**  
GlobalVo  
Français, Ita  
polski, Make  
日本語

[Home](#) [About](#) [For Bloggers](#) [For Media](#) [Special Coverage](#) [Sponsors](#)

## Kenya Elections Aftermath 2008

On Dec. 27, 2007 a surprise victory for former president [Mwai Kibaki](#) (PNU) in the Kenyan presidential election was followed by arson and violence aroused by suspicions of vote rigging.  More than 200 have been killed and tens of thousands displaced. Opposition candidate [Raila Odinga](#) (ODM) is contesting Kibaki's election, and has declared himself the winner. Much of the violence is directed towards Kikuyu communities, the tribe of Kibaki and many of the Kenyan establishment, but there have also been retaliations against other communities.



## Hapi #4 - Ndërtimi i linkeve në bllogun tuaj prej sajteve të tjera



Përcaktimi i fjalëve kryesore të vërteta për bllogun tuaj është vetëm gjysma e betejës. Pjesa e dytë është ndërtimi i linkeve në bllogun tuaj.

Numri dhe cilësia linkeve të cilat blloku juaj i merr prej vendeve të tjera do të ketë ndikim enorm mbi atë se sa mirë do të rangoheni.

Një prej shkaqeve kryesore pse Global Voices Online është i ranguar mirë te kërkuesit është shumë e thjeshtë sepse ka numër ENORM të linkeve të sajteve të tjera çdo muaj.

Vendosja e linkeve është shumë e mirë. Prandaj filloni me procesin.

Ekzistojnë disa metoda të përgjithshme që të vendosni linke në bllogun tuaj. Megjithatë, që t'i mbajmë mend gjërat thjeshtë, do të shqyrtojmë vetëm tri baza në këtë doracak.



### **Metoda A: Vendosja e artikujve tuaj në sajtet e mediave sociale – pa vendosur spam!**

Sot ekzistojnë shumë sajte të mediave sociale ku mund të anëtarësoheni dhe të merrni pjesë. Disa nga më të njohurit janë: Digg, StumbleUpon, Reddit, Twitter dhe Delicious.

Regjistrohuni në këto sajte ose të paktën në disa prej tyre dhe filloni me vendosjen e përmbajtjes e cila ju pëlqen – duke përfshirë edhe tuajën.

Asnjëherë mos vendosni vetëm linke të bllokut tuaj. Kjo menjëherë do të vendosë Ban sepse duket si spam.

Domethënë, mbani mend të kontribuoni në mënyrë sa më të sigurtë. Gjithmonë kur ju do të vendosni link në faqen e atyre sajteve, ata do të vendosni linke te faqja e vendosur.

Kur kjo faqe është e jotja, ti fiton link. :)



### **Metoda B – Kërkoni prej lexuesve tuaj t'i vendosin artikujt tuaj në sajtet mediave sociale**

Një trik shumë i thjeshtë dhe i shpejtë i cili mund t'ju ndihmojë për rritjen e linkeve në bllogun tuja është të kërkoni prej lexuesve tuaj ta vendosin përmbajtjen tuaj në sajtet e mediave sociale duke i shfrytëzuar profilet e tyre.

Këtë mund ta bëni duke vendosur thirrje për aksion në fund të artikujve tuaj, të cilët janë optimizuar për kërkuesit. Për shembull, thjeshtë mund të thoni: “Nëse ju pëlqen artikulli, ju lutemi vendoseni në Delicious ose shpërndajeni në Twitter. Ju faleminderit.”



### **Metoda C: Kërkim për vendosje të linkut prej bllogerëve relevantë – pa u ndjerë keq!**

Një mënyrë tjetër e thjeshtë që të ndërtoni linke në bllogun tuaj është të kërkoni bllogerë të tjerë të cilët shkruajnë për të njëjtat tema dhe të kërkoni prej tyre të vendosin linke në bllogun tuaj.

*Mos kërkoni menjëherë link. Së pari njihuni nëpërmjet komenteve në përmbajtjen e tyre, mandej pyetini. Shumë veta mund t'ju ndihmojnë me kënaqësi.*



## Vërejtjet përfundimtare



Në qoftë se keni lexuar gjithçka, urime. Tani dini disa këshilla themelore për optimizim të kërkuesve, të cilat do t'ju ndihmojnë ta ngrini rangun e bllokut tuaj dhe do t'ju ndihmojnë ta zmadhoni numrin e lexuesve dhe vizitave.

Megjithatë mbani mend ky doracak nuk duhet të kuptohet si qasje e përgjithshme për optimizim për kërkues. Ky është shkruar në mënyrë shumë të thjeshtë që kushdo të ketë mundësi ta ndjekë lehtë dhe të ketë dobi prej tij.

Shpresojmë se ishte e dobishme!



### Falenderim

Do të desha ta falënderoja [Sami Ben Grabija](#) që më nxiti ta shkruaj këtë doracak dhe ta ndaj njohurinë time m botën. Gjithashtu dua ta falënderoj të gjithë ekipin e GVO dhe të gjithë të Qendrës Berkman në Hauard, për punën e tyre dhe mbështetjen konstante në luftën për shprehje të lirë në internet. Kisha kënaqësi të madhe që ju njoha. Dëshiroj që miqësia jonë të vazhdojë edhe mandej dhe shprehja e lirë një ditë të bëhet realitet për të gjithë njerëzit e këtij planeti.



### Për autorin

Drima është kontribuues për Global Voices Online nga dhjetori i vitit 2006. Në jetën e tij profesionale ai ka punuar si konsulltant për internet marketing dhe on-line biznes, me fokus inicial të optimalizimit të kërkuesve, kurse më vonë ka menaxhuar me projekte on-line 7shifrorë. Ai ka vendos bllogje në [The Sudanese Thinker](#).

### Të drejtat autoriale

Ky doracak është licencuar nga  
[Krijtiv komons licenca – Burime të vendosura 3.0](#)